



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME DETARE

Nr. 1437/3 Prot

Durrës / 08 / 2022

VENDIM

NR. 7 DATË 10.08.2022

MBI PEZULLIMIN E QËNDRËS TRAJNUESE VMTC

Bazuar në memon nr 1437/1prot e datës 10/08/2022 nga kryetari i komisionit “Të testimit teorik dhe praktik për pajisjen me dëshmi aftësie për mjete të vogla lundruese” dhe akteve të konstatimit të grupit të punës sipas Planit të punës së miratuar me nr prot 1437 prot datë 08.08.2022, vihem në dijeni për problematikat e konstatuara gjatë inspektimeve në qëndren e trajnimit **Vlora Maritime Training Center (VMTC)** me administrator z. Agron Dukaj

Qëndrës së trajnimit Vlora Maritime Training Center, me administrator z. Agron Dukaj iu kërkua verifikimi i Regjistrimit të prezencës së trajnimeve të përfunduara, regjistri rezultoi i pa plotësuar. Përditësimi fundit daton më 06.04.2022 dhe pas kësaj date nuk është hedhur asnjë e dhënë në regjistër.

Për Trajnimin në process për të cilin është njoftuar Dpdetare dhe mban datën 07.08.2022 njoftohet se me date 07.08.2022 aplikantet e shënuar ne shkresen njoftim kane filluar kursin e trajnimit ne kundershtim me deklarimin e Administratorit të qendrës se nuk është paraqitur asnjë kursant në trajnim.

Qendra e trajnimit Vlora Maritime Training Center, në mënyrë të përsëritur ka shkelur Udhëzimin nr. 2 të Ministrit, Ndaj qendrës Vlora Maritime Training Center është marrë 1 (një) masë administrative. Me Vendimin nr prot 2183/5 datë 29.12.2021, “**Paralajmërim për pezullim aktiviteti**” nga Drejtoria e Përgjithshme Detare.


Për keto arsye në bazë të ligjit nr.10109 i datës 02.04.2009 “Për administratës Detare” si dhe pikës c, nenit 32 të Udhëzimit të Ministrit Nr.2, datë 05.05.2021, për “Kriteret e Kualifikimit dhe Kategoritë e Drejtimit të Mjeteve Lundruese në Republikën e Shqipërisë”, pasi kjo qendër trajnimi ka marrë 1 (një) masa administrative;

VENDOSA

Për qendrën e trajnimit **Vlora Maritime Training Center (VMTC)**, pezullim i aktivitetit të trajnimit për 3 (tre) muaj.

1. Qendrën e trajnimit **Vlora Maritime Training Center** do jetë e pezulluar të ushtrrojë aktivitetin e saj nga periudha 10.08.2022 deri më 11.11.2022
2. Ngarkohet Komisioni i testimit teorik dhe praktik për pajisjen me dëshmi aftësie për mjete të vogla lundruese” për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi sot me datë 10/08/2022
4. Subjekti **Vlora Maritime Training Center** ka të drejtën e ankimimit të këtij vendimi në organet kompetente brenda afateve të parashikuara nga Kodi i procedurave Administrative.

Konceptoi: M.Kurti
Praçoi: E.Tushaj
Miratoi: K.Hysko
Data: 10/08/2022
Nr.Kopje:03



DREJTOR I PËRGJITHSHËM

PAVLIN NDREU

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZV/DREJTOR I PËRGJITHSHËM & KAPITEN I PORTEVE

TOMOR HARIZI

